

Kopje e broshurës së Houseproud

Mirësevini në Houseproud

Nëse keni nevojë për riparime, përmirësime ose ndryshime në banesën tuaj Houseproud mund t'ju vijë në ndihmë.

Dihet që ideja për të kryer punime ndërtimi në shtëpi na tmerron dhe kjo jo vetëm sepse puna mund të kryhet nga një ndërtues i papërgjegjshëm ose shqetësimi mbi pagesën për punën e kryer. Kjo bën që shumë njerëz të tërhiqen mbrapsht.

Houseproud ofron një mënyrë të sigurt dhe pa trazira për kryerjen e punimeve të rëndësishme me profesionalitet. Gjithashtu nëse keni probleme me pagesën, Houseproud do t'ju jetë në ndihmë.

Janë të shumëllojshme huatë e dhëna nëpërmjet Houseproud të përbalueshme nga të gjithë dhe të menduara posaçërisht për persona të moshuar ose të paafhtë. Për më tepër, huatë kanë për garanci mos rimarrjen duke marrë parasysh çdo të papritur.

Houseproud drejtohet nga një grup shoqërisht të ashtuquajtura "Jo-për-profitim" me në krye një Këshill i përbërë nga ju. Qëllimi kryesor i tyre është të ndihmojë pronarët e shtëpive me moshë 60 vjeç e lart (ose familje me një person të paafhtë të çdo moshe në shtëpi) të riparojnë, përshtasin ose përmirësojnë banesën e tyre kështu që të mund të vazhdojnë të jetojnë të sigurtë dhe me sa më shumë pavarësi.

Si funksionon Houseproud?

Nga fillimi deri në përfundim Houseproud ofron një shërbim rregullues të hollësishëm duke marrë edhe mendimin tuaj për siguri.

Ju caktohet që në fillim konsulenti juaj personal i Houseproud detyra e të cilit është të diskutojë me ju mbi punimet që do të kryhen. Gjithashtu konsulenti përcakton nëse ju keni nevojë për ndihmë duke marrë parasysh konspektet e ndryshme të ndihmës.

Këshilli do të organizojë një vizitë nga konsulenti për të parë çfarë nevojë rregullimi ka në shtëpinë tuaj dhe se sa mund të kushtojë.

Me kryerjen e marrëveshjes mbi mënyrën e pagimit Këshilli cakton një ndërtues cilësor dhe mund të

fillojë puna. Këshilli gjithashtu inspekton që në përfundim puna të jetë mbaruar në mënyrë të kënaqshme.

Si mund të paguaj për punën e kryer?

Houseproud krijon mundësinë e një huaje pa rrezik dhe të përbalueshme dhe të paracaktuar posaçërisht për t'ju ardhur në ndihmë nevojave të personave të moshuar ose invalidëve. Me anë të Houseproud një pjesë e vlerës së shtëpisë tuaj mund të kthehet në një hua për të përbaluar pagesën e punimeve. Për vendosjen e tipit të huasë me të përshtatshme do të merret parasysh çdo rrethanë juaja. Në disa raste huaja së bashku me interesin nuk është e nevojshme të paguhet nga ju por shuma tërhiqet nga vlera e shitjes nëse shtëpia shitet në një të ardhme.

Me të ditur shumën që ju duhet ne marrim çdo masë për dhënien e huasë tuaj.

Dhe nëse nuk dua të marr hua ?

Nuk ka asnjë problem. Nëse doni të financoni vetë punimet ose të gjeni paratë diku tjetër ju keni mundësinë të përdorni shërbimin e Houseproud edhe pa alternativën e një huaje.

Kush janë tipet e huave ?

Ja tre alternativat kryesore mbi huanë:

- Hua çlirimi e kapitalit**
- Huadhënie vetëm me interesin**
- Huadhënie ripagesë e kapitalit dhe me interes**

Hua çlirimi e kapitalit:

Me këtë mënyrë nuk do t'ju duhet të bëni një kthim normal të huasë.

Huaja duhet të kthehet vetëm atëherë kur shtëpia nuk është më e vetmja që keni ose është shitur. Kur shtëpia është shitur për shembull, pas vdekjes, banka ose kompania e ndërtimit do të tërheqë shumën origjinale (kapitalin) të huasë, plus interesin e akumuluar, direkt nga procedura e shitjes duke vlerësuar në çdo rast sesi vlera e shtëpisë ka ndryshuar gjatë kohës.

Megjithatë, ju mund të filloni ripagimin e huasë nëse doni duke paguar në fillim interesin e më pas shumën e huasë. Gjithashtu keni alternativën e pagimit të huasë dhe interesit përkatës të gjithë së bashku. Nuk ka asnjë sanksion për shlyerje të huasë para kohe përveç vitit të parë kur do t'ju duhet të paguani një shumë interesi dy mujor.

Kjo hua në përgjithësi u jepet individëve ose çifteve me moshë 75 vjeç e lart. Për çiftet duhet një aplikim suplementar.

VERIFIKONI QË KJO FORMË HIPOTEKIMI DO T'JU HYJË NË PUNË ME TË VËRTETË NËSE DONI TË NDËRRONI A SHISNI SHTËPINË OSE DO TË DONI QË FAMILJARËT TUAJ TË TRASHËGOJNË ATË. PËR ÇDO HEZITIM KËRKONI KËSHILLË NË MËNYRË TË PAVARUR.

Huadhënie vetëm me interes:

Paguhet çdo muaj vetëm interesi mbi huanë. Ju do të vazhdoni të paguani interesin derisa shtëpia juaj të shitet. Shuma e huazuar (kapitali i huazuar) nuk pakësohet dhe ripaguhet edhe kur shtëpia nuk është me banesa juaj bazë ose kur shitet.

Kur shtëpia shitet, për të shlyer huanë, banka ose kompania ndërtimore do të tërheqë shumën e huasë fillestare plus çdo interes të ngelur nga shumata e parave të shitjes së shtëpisë.

Ju mund të filloni shlyerjen e huasë kur të dëshironi duke paguar edhe interesin mbi huanë derisa të keni shlyer të tërë huanë.

Mund të shlyeni shumën e huasë së bashku me interesin përkatës në çdo kohë, pa asnjë detyrim. Vetëm në vitin e parë disa banka a kompani ndërtimore mund t'ju ngarkojnë me pagesën e rreth dy muajve interes.

Kjo alternativë është në dispozicion të individëve ose çifteve me moshë 60 vjeç e lart ose familjarëve që kanë një person invalid në shtëpi.

Huadhënie ripagesë e kapitalit dhe me interesin:

Ky është një hipotekim i mirëfilltë. Ripagimi mujor përfshin pjesën mbi huanë së bashku me interesin mbi shumën. (kapitalin)

Albanian

Për kohën e shlyerjes së huasë ju bini dakort me huadhënësin. Sa më e shkurtër është koha e shlyerjes së huasë aq më shumë do t'ju duhet të paguani në muaj por patjetër që koha e shlyerjes të tërë huasë do të jetë më e shkurtër.

Kjo alternativë është në dispozicion të individëve ose çifteve me moshë 60 vjeç e lart ose familjarëve me një person invalid të çdo moshe në shtëpi.

Kush është përqindja e interesit mbi shumën e huazuar?

Interesi mbi hipotekën ndryshon në varësi të kohës. Oferta formale konfirmon përqindjen e interesit në momentin e marrjes së huasë. Do t'ju bëhet i ditur çdo ndryshim mbi ndryshimin e përqindjes së interesit.

Si mund të zgjedh alternativën më të mirë për një hua?

Ne duam që ju të bëni zgjedhjen më të favorshme dhe për këtë Houseproud ju ofron shërbimin e një konsulentit financiar të pavarur pa pagesë. Në raportin e tij ai do të rekomandojë alternativën financiare më të mirë për ju.

Do t'ju këshillojmë gjithashtu të diskutoni gjithçka me pjesëtarët e familjes dhe nëse e shihni të arsyeshme me konsulentin tuaj legal.

Kam dëgjuar njoftime shqetësuese për sisteme të tilla. Çfarë sigurie kam me këtë sistem?

Houseproud përkrahet nga këshilli juaj lokal dhe partnerët e tij qëllimi kryesor i të cilëve është t'ju sigurojë juve një jetë sigurtë dhe të pavarur në shtëpinë tuaj.

A ka rrezik të humbas shtëpinë?

Shtëpia juaj nuk është asnjëherë në rrezik me Houseproud. Të gjitha alternativat e huasë kanë garanci për moskërkim posedimi të shtëpisë përsa kohë ju jeni duke jetuar në të.

Çfarë shume mund të marr hua?

Të ardhurat tuaja dhe vlera e shtëpisë tuaj do të merren parasysh për të vendosur mbi shumën e huasë që ju mund të merrni. Zakonisht shumata luhet tek 3,000 £ deri në 30% të vlerës reale të pronës tuaj.

Ne duhet të sigurohemi, kjo edhe për të mirën tuaj, që nëse ju vendosni të merrni një hua të jeni në gjëndje ta paguani pa u mbi sforcuar veten tuaj.

A do të kem nevojën e ndonjë sigurimi ?

Po. Nëse merrni një hua shtëpia juaj duhet të jetë e përfshirë në planin e një sigurimi për shtëpinë.

Me marrjen e ‘Hua e çlirimit të kapitalit’ në rast se jeni të siguruar nga një kompani sigurimi e ndryshme nga ajo e huadhënësit, sipas kontratës, do t’ju duhet ti paguani bankës ose kompanisë ndërtimore një shumë administrative prej 10£ në vit . Për llojet e tjera të huave ,nëse banka ose kompania ndërtimore nuk kanë përfshirë sigurimin,mund t’ju bëhet një ulje mbi pagesën prej 25£.

A do të më duhet ndonjë kontroll mjekësor?

Zakonisht nuk kërkohet asnjë lloj evidence mbi shëndetin tuaj;megjithatë,për personat nën 60 vjeç do të na duhet diçka që konfirmon që në familje kanë një person invalid.

Jam titullar I një fondi ndihme per invalid - a mund edhe të marr hua tek Houseproud?

Po. Nëse jeni titullar i një fondi ndihme për invalid, Houseproud shpesh mund t’ju ndihmojë për ndonjë shpenzim financiar që mund të keni për punimet ose për ndonjë punim suplementar që nuk mbulohet nga ky fond.

A ka kufij për moshën?

Nëse merrni ‘Huadhënie ripagesë e kapitalit edhe me interes’ ose ‘Huadhënie vetëm me interes’ju duhet të jeni me moshë 60 vjeç e lart ose të keni një person invalid në shtëpi. Për persona me moshë më të madhe, përshembull ata me moshë 75 vjeç e lart, është në dispozicion ‘Hua çlirimi e kapitalit’.

A ka shpenzime shtesë?

Janë shpenzimet për vlerësimin anën legale dhe administrative. Houseproud është munduar ti bëjë këto shpenzime sa më të përballueshme nga ju. Këto shpenzime do t’ju bëhen të ditura përpara se ju të vendosni mbi marrjen e një huaje(nëse nuk merrni hua nuk keni asnjë detyrim financiar) dhe këto shpenzime mund të përfshihen në shumën e huasë për të mos t’ju bërë të vini dorë në kursimet tuaja. Për çdo rast, ekziston gjithmonë mundësia e një ndihme financiare për përballimin e këtyre shpenzimeve. Konsulenti i juaj i Houseproud do t’ju japë edhe më shumë informacion.

Çfarë punimesh mund të kryhen nën tutelën e Houseproud?

Ja disa shembuj:

- Banjo e re
- Instalim i ri elektrik
- Punime mbi sistemin e ngrohjes
- Çati e re
- Zëvendesim i dyerve dhe dritareve
- Ulluqe shkarkimi të reja
- Punime hidraulike
- Riparime në dhomën e gatimit
- Siguria e një shtëpie më të mirë
- Përshtatje për t’ju ndihmuar nëse keni një person invalid në shtëpi
- Përmirësimi i rendimentit të energjisë në shtëpinë tuaj

Çfarë ofron Houseproud?

- Ndihmë dhe mbështetje me anë të konsulentit të Houseproud.
- Udhëheqje eksperte e një konsulenti financiar të pavarur.
- Shërbimet e stafit teknik duke përfshirë ardhjen në shtëpinë tuaj për kryerjen e një preventivi të detajuar mbi punimet.
- Ndërtues të mirë dhe të besueshëm .
- Inspektim I rregullt i punimeve të ndërtimit. Ndërtuesit paguhën vetëm kur puna e tyre është kryer me një standart të kënaqshëm.

Doni të dini më shumë?

Do t’ju duhet vetëm të plotësoni kartën e parapaguar postale (të bashkëngjitur) ose të telefononi në linjën për asistencë në numrin **0800 7837569** dhe do t’ju dërgojmë falas një pako informative së bashku me një videokasetë mbi Houseproud.

Asnjë aplikant nuk do trajtohet me më pak respekt nga Houseproud pa dallim rrace, ngjyre, etnie apo origine, seksi, statusi martesor, orientimi seksual, moshe ose te paaftësie.

Kjo broshurë duhet të lexohet së bashku me shtojcën e detajuar informative mbi përqindjet e interesit. Një vlerësim i shkruar është në dispozicion në bazë të një kërkesë nga ana juaj. Nëse shtojca mungon ju lutemi të na telefononi në numrin falas **0800 783 7569**.

Shtëpia juaj është në rrezik nëse nuk respektoni shlyerjen mbi hipotekimin ose hua të tjera që kanë për siguri atë.